

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Qershor, 2015*

Vizitë me rëndësi e Internacionales Botërore të Arsimit në Kosovë **EI vizitoi SBASHK-un**

Sekretari i Përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, Fred van Leeuwen dhe Walter Dresscher nënkryetar i ETUCE dhe kryetar i AOB-së (Sindikates së Arsimit të Holandës) kanë qëndruar në Kosovë në fillim të qershorit. Ata fillimisht janë pritur në një takim miqësor nga kryetari SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe anëtarët tjerë të Kryesisë. .. (faqe 5)



Takimet informative me anëtarët e SBASHK-ut nëpër Komunitet e Kosovës

30 Takimet me mësimdhënës

Duke vazhduar me realizimin e agjendës së takimeve me mësimdhënës në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK- KEC(faqe 8)

Intervistë me z.Reshit Kushaj, kryetar i nivelit komunal - Prizren
Anëtarë i SBASHK-ut që nga themelimi i saj

Reshiti është një mësimdhënës i përkushtuar si dhe një aktivist i SBASHK-ut që nga themelimi i saj. Me aktivitetin e tij sindikal ... (faqe 3)

Dy seminare të suksesshme me sindikalistët nga 4 komuna të Kosovës

Forcohen kapacitetet njerëzore të SBASHK-ut



Projekti "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore" që po zhvillohet me sukses falë bashkëpunimit të mirë mes (faqe 7)

SBASHK-u dërgon 370 mësimdhënës në bregdetin shqiptar

Në valët e qeta të detit e në vallen e bukur shqipe



Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u ka vazhduar edhe këtë verë me traditën e mirë për të ... (faqe 5)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC

Editorial

Njerëz të mirë



Janë njerëz të mirë të punësuarit në arsimin e Kosovës. Kanë qëndrim burrëror dhe e mbrojnë me dinjitet emrin dhe misionin e tyre të shenjtë. Kështu ishin edhe në vitet e vështira të Kosovës, kështu janë edhe sot. Kënaqen me pak kujdes këta njerëz. Ata edhe dinë të rebelohen e të bëjnë greva, por kurrë nuk i kanë dashur ato. Një pjesë e të punësuarve në arsim ishin në këtë fundqershor në bregdetin shqiptar. Po pushonin në bazë të një aktiviteti tradicional të SBASHK-ut për anëtarësinë e vet.

Pronari i Kompleksit Turistik, gjithë stafi, por edhe vizitorët aty shprehnin respektin më

të lartë dhe , si fshehurazi , e pranonin se kur kanë për 370 njerëz që po zbarkonin në oborrin e Hotelit kishin shtruar pyetjen se çfarë mund të ndodh gjatë këtyre ditëve. Por, pushuesit dëshmuar për të satën herë se janë njerëz të mirë dhe kudo janë e ruajnë emrin madh të mësuesit.

Humori i lehtë, bashkëbisedat serioze për çështjet sindikale dhe për kushtet e punës në shkolla, vallja e bukur e spontane në mbrëmjet e bukura buzë detit zbukuronin atmosferën. Përshtypjet e shumë pushuesve kanë mbetur të shkruara në fletoret, që do të ruhen me kujdes në SBASHK.

Ata kanë lavdëruar SBASHK-un për gjithë angazhimet. Kanë lavdëruar që po vazhdon me traditën e bukur të organizimit të pushimeve në bregdetin e bukur shqiptar. Ata kujtuan se para 4 vitesh u fillua me 100 pushues për të arritur këtë vit në 370. Vitin e ardhshëm do të jenë edhe më shumë. E meritojnë këtë angazhim këta njerëz të mirë.

Rrahman Jasharaj

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", SBASHK-u nga **1 marsi 2015** ofron shërbime juridike për anëtarët e vet.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK) përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Implemented by:



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Kulturës

KEC



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Intervistë me z.Reshit Kushaj, kryetar i nivelit komunal – Prizren

Anëtarë i SBASHK-ut që nga themelimi i saj



Reshiti është një mësimdhënës i përkushtuar si dhe një aktivist i SBASHK-ut që nga themelimi i saj. Me aktivitetin e tij sindikal, ai ka bërë që mësimdhënësit e Prizrenit ta kuptojnë shumë mirë rëndësinë e sindikatës dhe të jenë

në radhët e anëtarëve të SBASHK-ut.

Reshiti edhe pas kaq shumë viteve të aktivitetit sindikal, vazhdon të kontribuoj për sindikatën në mënyrë të palodhshme.

1. Kush është Reshit Kushaj?

Reshit Kushaj, jam qytetar i Prizrenit, jam lindur më 3 Nëntor 1960, në fshatin Samadraxhe, komuna e Therandës (ish Suhareka) fëmijërinë dhe tre vitet e para të shkollës fillore i kam mbaruar në fshat dhe prej vitit 1970 jetoj në Prizren.

Shkollimin fillor dhe shkollën e mesme i mbarova në Prizren, kurse studimet e larta -fakultetin dhe studimet post -diplomike në Prishtinë në degën e Historisë. Me përfundimin e studimeve prej vitit 1984 fillova me punë si mësimdhënës i historise në fshatrat e komunës së Prizrenit edhe në qytetin e Prizrenit ku gjindem edhe tani.

Me fillimet e luftës së fundit në vitin 1988, rreshtohem në radhët e UQK-së, deri në përfundimin e saj, pas 19 shtatorit 1999, kur dhe bëhet demilitarizimi prej UQK-se në TMK, unë bëj pjesë në radhët e TMK-së (Trupat Mbrojtës të Kosovës në pozitat komanduese të saj tek Batalioni 80 i MKABK-se, Njesi vartese e shtabit të përgjithshëm, në TMK, do të jem deri në vitin 2001, kur dhe me vet dëshirë largohem prej TMK-së dhe filloj me punë në arsim.

Në mësimdhënie ku gjindem edhe tani, por jo si mësimdhënës, pasi që prej marsit të vitit 2008, kaloj

punë me anë të një konkursi të rregulltë, në të cilin fitoj në mesin e shumë kandidatëve dhe prej atëhere gjendëm në pozitën e zyrtares të arsimit parauniversitar në komunën e Prizrenit. Nga e cila pozitë edhe pse më pagën shumë më të ultë se sa të mësimdhënësit, me njohjet që i kam për arsimin, bëj përpjekje të vazhdueshme që të kontribuoj për zhvillimin e arsimit dhe rritjen e cilësisë dhe në ngritjen profesionale të mësimdhënësve.

Në këtë pozitë jam duke punuar dhe tani, përveç punëve dhe obligimeve që i kam në vendin e punës, kontribut të vazhdueshëm filloj të jap edhe tek sindikatat arsimore në veçanti në komunën e Prizrenit.

2. Cfarë pozite keni në SBASHK?

Reshit Kushaj në SBASHK, kam filluar si anëtar i thjeshtë i saj, qysh prej vitit 1990, prej kohës kur populli ynë dhe vendi ynë ndodhej para grackave dhe rreziqeve të mëdha, në veçanti arsimit shqip, atëherë unë me një grup shokësh në komunën e Prizrenit siç ishin prof. Azem Mazreku, Hilmi Gashi, Ymer Buqaj, Besa Elshani, Sutjeska Fana dhe shumë të tjerë, i formuam shoqatat sindikale pranë shkollave si dhe organizuam shumë tubime dhe protesta në mbrojtje të shkollës shqipe.

Prej anëtarit të thjeshtë në SBASHK, pas një kohe të shkurtër pasi që veç isha veprimtar dhe kryetar i një shoqate shumë të madhe arsimore në kolektivin ku punoja me 107 anëtar, atëhere u zgjodha në organet e SBASHK-ut në Prizren ku deri në fillimin e luftës së UQK-se isha në pozitën e nëkryetarit të SBASHK-ut për Prizren, pas mbarimit të luftës dhe angazhimit tim në TMK, pushova aktivitetet në SBASHK, por pas rikthimit tim në Arsim në vitin 2003/2004, duke e parë gjendjen e rëndë të mësimdhënësve si atë pozitën materiale si dhe nëpërkëmbjen e dinjitetit të tij profesional si prej udhëheqjes vendore dhe asaj ndërkombtare, unë me kërkesën e shumë shokëve të mi në arsim riorganizohem në SBASHK.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



3. Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Në SBASHK, ka shumë për të veçuar, vite me përpara kishte raste kur disa prej kolegeve tanë udhëheqësa nëpër nivele komunale ishin shumë të politizuar, kurse mendoj se tani kjo është shumë më pak e shprehur dhe punët janë duke shkuar për së mbari dhe njëherë po ritheksoj se anëtarët e SBASHK-ut e në veçantë udhëheqësit nuk duhet të jenë të politizuar, dhe gjithë kjo është me rëndësi për të pasur besueshmeri të anëtarësia sindikale.

4. Çfarë duhet të bëjë më shumë SBASHK-u për ta forcuar rolin sindikal?

U përgjigja në pyetjen me lartë, të depolitizohet përfundimisht, të jetë i përfaqësuar duke i respektuar në veçanti rajonizimet, mos të ketë zgjedhje e rizgjedhje në SBASHK, në baza të akraballekut e familjarizimit, të organizoj me shumë vizita studimore në shtetet e tjera, dhe në këto vizita të përfshihen edhe udhëheqes lokal dhe veprimtar të Sbashk-ut.

Të ketë takime më shumë me udhëheqjen dhe anëtarësinë sindikale nëpër nivele komunale, të organizoj me shumë puntori që të njoftohet anëtarësia sindikale me të drejtat e tyre etj.

5. Cilat trajnime do t'ia propozonit SBASHK-ut për anëtarësinë e vet?

Une mendoj se SBASHK-u ka kapacitete të mjaftueshme për të qenë pjesë e projekteve të shumta, të vazhdon me trajnimet për ndërtimin e fuqizimit dhe rolit të anëtarëve të SBASHK-ut, me trajnime për të drejtat në punë, dhe mbrojtja në vendet e punës, mendoj se stazhi i gjatë në arsim dhe gjendja psiko-sociale e punëtorve të arsimit për shkak të natyrës së punës, ka nevojë të organizohen edhe trajnime për stres dhe trauma (Këto trajnime janë organizuar prej SBASHK-ut vite më përpara), trajnimet si ECDL-i etj.

6. Çka mendoni për shërbimet e SBASHK-ut ndaj anëtarësisë?

Eh kjo është pyetje shumë interesante, viteve të fundit SBASHK-u në këtë drejtim e ka filluar mbarë e mirë dhe duhet të vazhdohet edhe me tutje, këto shërbime mos të ju mundësohen vetëm përmbrinda Kosovës por edhe në shtetet e tjera, me theks të veçantë, të nënshkruhen marrëveshje me shtete në rajon edhe për ngritje profesionale të mësimdhënësve, si dhe për studime të fëmijëve të anëtarëve sindikal kuptohet me lirime, për punësime sezonale etj... si dhe ka edhe shumëçka që duhet dhe është mirë të bëhen në të ardhmen.

7. Sa është përfshirja e të rinjve dhe femrave në arsim në komunën tuaj?

Eh Prizreni është qyteti më interesant në Evropë e më gjërë sa i përket kësaj pyetje, ka në radhet e SBASHK-ut shumë të rinjë, që prej ditës së parë që fillojnë me punë dhe anëtarësohen, mbi 70% janë femra.

Arsimi ka traditë prej shumë kohësh në Prizren, në SBASHK-un e Prizrenit, janë të anëtarësuar edhe puntorët arsimor prej radhëve të komuniteteve si Boshnjaket, Turqit, komunitetet RAE, dhe të tjerët, pasi që mësimi në Prizren përvëq në gjuhën shqipe organizohet edhe në atë boshnjake e turke e viteve të fundit edhe në gjuhën rome dhe bashkëpunimi dhe interesimi i tyre është shumë i madh për të i përkrahur dhe mbështetur të gjitha aktivitetet që organizohen nga SBASHK-u, përfshi edhe grevat.

8. A keni diçka për të shtuar dhe që ne nuk iu kemi pyetur?

Po pas unë jam kryetar i nivelit lokal të SBASHK-ut edhe për komunitetet, është mirë që administrata e përgjithshme në shkallë vendi në Prishtinë, dokumentet zyrtare informatat, njoftimet si dhe dokumentet tjera, të mundohuni me i siguruar edhe në gjuhët e minoritetëve pasi që edhe ata janë antarë të SBASHK-ut, si gjithë të tjerët, si dhe për fund opinionimi dhe i anëtarësisë në komunën e Prizrenit është se dy viteve të fundit po punohet shumë në SBASHK.

Vizitë me rëndësi e Internacionales Botërore të Arsimit në Kosovë EI vizitoi SBASHK-un



Sekretari i Përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, Fred van Leeuwen dhe Walter Dresscher

nënkryetar i ETUCE dhe kryetar i AOB-së (Sindikatës së Arsimit të Holandës) kanë qëndruar në Kosovë në fillim të qershorit. Ata fillimisht janë pritur në një takim miqësor nga kryetari SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe anëtarët tjerë të Kryesisë.



Sekretari i Përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit z. Leeuwen u shpreh i emocionuar që

pas 8 vitesh prapë vizitoi Kosovën dhe pa nga afër arritjet e SBASHK-ut. Leeuwen në një takim rasti me kryetarin e parë të SBASHK-ut, dr. Agim Hyseni dhe me veprimtarë të kësaj sindikate ka kujtuar momente të veçanta nga kohët e okupimit të Kosovës duke treguar për angazhimet e singerta të Internacionales Botërore të Arsimit për ta përkrahur kauzën dhe misionin e shenjtë

të mësimdhënësve të Kosovës në përpjekjet për ta mbrojtur arsimin shqip gjatë gjithë atyre viteve.

Edhe Walter Dresscher nënkryetar i ETUCE dhe



kryetar i AOB-së (Sindikatës së Arsimit të Holandës) u shpreh i kënaqur me arritjet e SBASHK-ut dhe

ka këshilluar mikpritësin që të vazhdoi me angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Leeuwen dhe Dresscher kanë qëndruar edhe në ambientet e Shkollës së Gjellbër në Prishtinë dhe janë shprehur të lumtur me mikpritjen e drejtoreshës, nxënësve dhe të punësuarve në këtë institucion arsimor. Ata kanë lavdëruar punën dhe përkushtimin e të gjithëve në këtë shkollë.

Sekretari i Përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, Fred van Leeuwen dhe Walter Dresscher, nënkryetar i ETUCE dhe kryetar i AOB-së në takimin e mbajtur me udhëheqës të SBASHK-ut, janë shprehur në emër edhe të 31 milionë anëtarëve sa ka sot EI se janë gjithmonë të gatshëm që ta mbështesin dhe përkrahin SBASHK-un në angazhimet që kjo sindikatë vazhdon t'i bëjë në shërbim të anëtarësisë

SBASHK-u dërgon 370 mësimdhënës në bregdetin shqiptar

Në valët e qeta të detit e në vallen e bukur shqipe



Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u ka vazhduar edhe këtë verë me traditën e

mirë për të dërguar punëtorë të arsimit dhe UP-ja nga të gjitha komunat e Kosovës për pushime në bregdetin shqiptar.

Mësimdhënësit dhe të punësuarit tjerë në arsimin e Kosovës kanë shprehur gëzimin e tyre që janë përzgjedhur nga shkollat e tyre që të jenë për disa ditë pushimi në bregdetin e bukur shqiptar. Ata kanë lavdëruar edhe Kryesinë e SBASHK-ut dhe komisionin 10 anëtarësh që ka punuar me përkushtim në mënyrë që pushimet të jenë sa më të organizuara.

Të 370 anëtarët e SBASHK-ut kanë kaluar për mrekulli

Implemented by:

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



pushimet në
bregdetin shqiptar
në Durrës.
Qëndrimi i tyre në
buzëdet është një
traditë që po
vazhdon dhe
sigurohet nga
mjetet e
grumbulluara në
Fondin për

rekreacion të SBASHK-ut. Pushuesit janë shprehur me respekt për gjithë angazhimet e SBASHK-ut dhe për këtë aktivitet rekreativ duke shtuar disa nga ata se janë për të parën herë në bregdetin e bukur shqiptar.


Shumë nga këta pushues kanë lënë përshtypjet e tyre në formë të shkruar. Fjalët ishin të thjeshta aty, por falënderimi vinte nga zemra.

Kjo atmosferë bëhej edhe më dinamike çdo mbrëmje në freskun e pishave. Melodia e bukur e këngës shqipe shoqërohej me puhinë dhe me vallen e lehtë të valëve të detit.

Në valle hynin plot elan e gaz edhe pushuesit. Disa shihej se kishin traditë në vallet e bukura shqipe, por kishte edhe nga ata që sikur po nisnin me vallen për të parën herë. Ani, s'ka gjë. Atmosfera dhe ndjenja e gëzimit mes pushuesve nuk lente të shihej ndonjë gabim i fillestarëve të valles. Valle të gëzimit ishin këto.

Gjatë gjithë kohës së pushimeve kryetari i Komisionit, Ymer Ymeri me një pjesë të mirë të anëtarëve të tjerë rinin në gjendje mobile.

Ata kujdeseshin për çdo gjë. Shkonin nga tavolina në tavolinë dhe interesoheshin se mos ka ndonjë ankesë, por ankesa nuk kishte. Çdo gjë shkonte bukur. Ditët




kanë ikur shpejt e pushimi për këtë vit përfundoi. Pushuesit përshëndeteshin me njëri-tjetrin duke këmbyer adresa e numra telefonash. Ditë të paharruara për ne do të jenë këto, shpreheshin ata duke shkuar drejt autobusëve. Po ktheheshin në shtëpi plot gaz e plot përshtypje e kujtime të bukura. Me ta

gjatë gjithë pushimit kishte qëndruar edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj. Ai ka përshëndetur pushuesit në një fjalë rasti duke u shprehur krenar me sjelljen dinjitoze të këtyre mësimdhënësve sindikalistë. Qindra foto kanë bërë pushuesit me kryetarin dhe ato do t'irruajnë për kujtim nga këto ditë të bukura pushimi.

Duke shfletuar përshtypjet e lëna nga shumë pushues në dy fletore njeriu ndjehet mirë. Të gjithë falënderojnë udhëheqësinë e SBASHK-ut për këtë aktivitet. Ata kanë fjalët më të mira edehe për kryetarin e Komisionit të pushimeve, z. Ymer Ymeri, për Nezafeten, por edhe për anëtarët tjerë të Komisionit.

“Falënderojmë SBASHK-un për këtë aktivitet të qëlluar. U takuam këtu mësimdhënësit nga të gjitha



viset e Kosovës si një familje e madhe.

Kohën nuk e kemi kaluar vetëm duke pushuar, por edhe kemi bashkëbiseduar për çështje profesionale.

Këmi këmbyer përvoja. Kemi mësuar shumë nga njëri-tjetri”, shprehet një profesoreshë nga Deçani. Trajtimi korrekt dhe i barabartë për të gjithë.

Kultivimi i frymës kolegjiale, i frymës së miqësisë e solidaritetit. Bashkëbiseda për përvojat tona në arsim.

Bashkëbiseda për shumë çështje sindikale, kënga e vallja i kanë bërë këto pushime shumë të këndshme”, shton në përshtypjet e tij një profesor nga “Gjon Sereçi” i Ferizajt. Përshtypje në formë të shkruar kanë lënë edhe shumë pushues. Ka edhe përshtypje të përmbledhura në emër të pushuesve nga komunat e Kosovës. E përbashkëta është se ditët e pushimit kanë ikur shumë shpejt. Nga këto përshtypje do veçuar ato të një pushuesi Ismail R. Hoti nga Abria e Drenasit. Ismajli atë që e ndiente e kishte thënë thjeshtë e bukur përmes vargjeve.

“Valët kaltëroshë radhë-radhë, s'ka me bregdetin shqiptar”... kishte nisur këtë poezi ky mësimdhënës dhe përmes vargjeve tjera kishte përshkuar atmosferën e bukur buzë detit duke mos harruar të falënderonte SBASHK-un për gjithë këtë aktivitet.

Në SBASHK-u do të ruhen me kujdes këto fletore me përshtypjet e pushuesve.

Urojmë që edhe në vitet e ardhshme të organizohen kaq bukur pushimet për anëtarët e SBASHK-ut. Urojmë që të vazhdohet me këtë frymë bashkëpunimi e uniteti.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Dy seminare të suksesshme me sindikalistët nga 4 komuna të Kosovës Forcohen kapacitetet njerëzore të SBASHK-ut



Projekti "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore" që po zhvillohet me sukses falë bashkëpunimit të mirë mes SBASHK-ut dhe KEC-it dhe mbështetjes së Komisionit Evropian, gjegjësisht zyrës së BE-së në Prishtinë ka bërë që të forcohen kapacitetet njerëzore të sindikatës sonë. Në këtë rrjedhë janë organizuar edhe dy seminare me veprimtarë sindikalë nga komune Mitrovicës, Vushtrrisë, Pejës dhe Gjakovës

Në seminarin e parë përfaqësues nga Mitrovica dhe vushtrria kanë dëgjuar me interesim prezantimet që kanë bërë tgrajnerët e licensuar për dialogun social Ymer Ymeri e Vjollca Shala. Këta dy trajnerët kanë arritur që përmes bashkëbisedës me pjesëmarrësit të krijojnë atmosferë punë dhe që të gjithë duke u ndarë në grupe pune kanë dhënë ide dhe kanë zgjedhur me përpikëri detyrat e shtruara.

"Hyrje dialogun social", "Dialogu social në kontekstin



kombëtar", "Dialogu në nivel evropian", "Zgjidhja e konflikteve", "Negocimi me punëdhënësit", ishin disa nga temat që u shtjelluan gjatë tri ditëve të seminarit. Në fjalën përshëndetëse kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka përmendur arritjet e Projektit "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore" dhe bashkëpunimin korrekt e domethënëses mes të KEC-it dhe SBASHK-ut. Ai ka theksuar se ky projekt përmes trajnimeve ka bërë që SBASHK-u të

ketë trajnerë të licensuar për shumë tema kyçe për SBASHK-un. Ai ka përshëndetur trajnerët e licensuar për dialogun social Vjollca Shala, Ymer Ymeri, Vlora Rexhepi Berisha dhe përfaqësuesin e KEC-it, z. Sokol Statovci.

Moment i veçantë në këtë seminar u krijua kur pesë grupet e punës zhvilluan trajnimin praktik duke u ndarë në punëdhënës dhe të tjerët në përfaqësues sindikalë. Pjesëmarrësit aq ishin thelluar në çështje sa që krijohej përshtypja se kemi të bëjmë me raste shumë reale, që po



ndodhnin pikërisht në momentin që po zhvillohej ky trajnim. Pjesëmarrësit e treguan praktikisht se gjatë gjithë këtij trajnimit kanë shtuar njohuritë për dialogun social dhe do të jenë të gatshëm për të përfaqësuar sindikatën në dialogun që do të zhvillohet që nga shkollat, në nivelin komunal me punëdhënësin e pse jo edhe në nivelin qendror duke iu bashkëngjitur ekipeve negociuese sipas situatës dhe aktualitetit.

Edhe seminari i dytë ishte mjaft përmabjtësor. Trajneri Haki Shyti ka nxitur shumë çështje për debat dhe pjesëmarrësit janë bërë personazhe aktive të temave "Hartimi i politikave arsimore dhe avokimi në Kosovë". Pjesëmarrësit duke punuar në grupe kanë dhënë shembuj të shumtë dhe kanë shtruar edhe pyetje në të cilat iu janë përgjigjur trajneri Shyti, juristi Shatri, përfaqësuesja e MASHT-it por edhe vetë pjesëmarrësit. Gjatë këtij trajnimit u trajtuan edhe tema të tjera me rëndësi dhe pjesëmarrësit nga Peja dhe Gjakova, u zotuan që tema të tilla të debatojnë me kolegët nëpër shkollat e tyre.. Në pjesën e dytë të këtij seminarit me pjesëmarrësit ka bashkëbiseduar znj. Igballe Cakaj, e cila është ndalur të çështje shumë me rëndësi lidhur me procesin e licensimit dhe performancës së mësimdhënësve të Kosovës. Ajo ka ofruar shifra e fakte lidhur me aktivitetet që MASHT-I ka zhvilluar lidhur me këtë çështje me rëndësi.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Kulturës

KEC





Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, në mbyllje të këtij seminari, ka lavdëruar punën e përkushtuar të trajnerëve Ymer Ymeri dhe Vjollca Shala dhe ka përgëzuar pjesëmarrësit për angazhimet, qëndrimin dinjitoz të tyre dhe unitetin që është edhe forcë e madhe e SBASHK-ut.

Takimet informative me anëtarët e SBASHK-ut nëpër Komunitat e Kosovës 30 takimet me mësimdhënës

Duke vazhduar me realizimin e agjendës së takimeve me mësimdhënës në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK- KEC "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore",

Është zhvilluar një turne takimesh në të gjitha komunitatet e Kosovës, ku të ftuar ishin kryetarët e shoqatave në nivel shkolle dhe shumë mësimdhënës.

Takimet filluan nga qyteti i Mitrovicës pastaj në Vushtri, Skenderaj, Drenas, Obiliq, Fushë Kosovë, Klinë, Istog, Junik, Decan, Pejë, Gjakovë, Malishevë, Rahovec, Prizren, Suharekë, Dragash, Shtime, Lipjan, Ferizaj, Viti, Hani Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Gjilan, Prishtinë, Podujevë, Zveçan, Shipol, Bardosh.



Në kuadër të kornizës ligjore për ZHPM janë nxjerrë këto UA:

Udhëzimi Administrativ i Vlerësimit të Performances së Mësimdhënësve,

UA për Zbatimin e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve,

UA për financimin e Zbatimit të Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve,

Janë licencuar 22.353 mësimdhënës në kuadër të 7 rajoneve. Në kuadër të trajnimeve janë përfshirë 11.088 mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave, duke përfshi edhe mësimdhënës të komuniteteve.

Gjendja aktuale në aspektin legjislativ :

Ligji i arsimit parauniversitar & UA 05/2010

Licencimi i mësimdhënësve

(Licencat janë dhënë në 2013 për 5 vite) faza e tjetër e licencimit do të fillojë prej 2017

Zhvillimi Profesional i Akredituar nga MASHT (së paku 100 orë të ZHP gjatë 5 viteve licencë)

Vlerësimi i Performancës së mësimdhënësve, (duhet të vlerësohet secili mësimdhënës para skadimit të licencës).

SBASHK-u në kuadër të këtij projekti, e ka marrë për obligim që të jetë pranë mësimdhënësve dhe të informojë ata për procesin e ri-licencimit që do të fillojë në vitin 2017. Këto takime janë zhvilluar në të gjitha komunitatet e Kosovës, vetëm e vetëm që të gjithë mësimdhënësit të jenë të përgaditur, kur të fillojë kjo fazë e licencimit për ata që ende nuk i kanë marrë licencat dhe për ata mësimdhënës që janë të licencuar dhe duhet të ri-licencohen.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte informimi i mësimdhënësve për procesin e licencimit. Në këto takime u shtjellua në tërësi procesi i licencimit, kushtet që duhen të plotësohen, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, zhvillimi profesional dhe shumë informacione tjera të nevojshme për të gjithë të pranishmit.

Ata kishin mundësi të merrnin përgjigjet menjehere nga ana e panelistëve që ishin në gjendje gadishmërie t'u përgjigjeshin pyetjeve të mësimdhënësve.

Nga secili takim mësimdhënësit janë ndarë të kënaqur nga informimet që ata kanë pasur rastin të marrin gjatë këtyre takimeve të mbajtura.

Në të gjitha takimet kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka folur për sfidat dhe për arritjet e SBASHK-ut. Ai është shprehur krenar për unitetin që mësimdhënësit kanë treguar dhe vazhdojnë ta tregojnë akoma, duke forcuar rolin e SBASHK-ut në përpjekje për të realizuar kërkesat e mësimdhënësve.

Në kuadër të këtij projekti "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", mësimdhënësit janë informuar lidhur me licencat dhe përgatitjet që ata duhet bërë që licencimi i ri t'i gjej të

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



gatshëm me qëllim që këtë proces ta kryejnë me sukses



duke u përgjigjur kështu edhe në shumë pyetje.

Ne këto takime mësimdhënësit kanë pasur mundësinë të njoftohen nga afër për shërbimet juridike që ofron

SBASHK-u për anëtarët e saj, si edhe për 100 marrëveshjet që SBASHK-u ka nënshkruar me bizneset dhe institucionet shëndetësore e rekreative private për zbritje çmimesh të shërbimeve për mësimdhënësit që kanë kartela sindikale.

Nga të gjitha komunat e vizituara, kemi pasur rastin të shohim më nga afër çështjet që i preokupojnë mësimdhënësit, duke u munduar që të informohen sa më mirë për çdo problem që mund t'iu shfaqet gjatë vitit shkollor. Mësimdhënësit ishin shumë aktiv dhe shumë të interesuar për procesin e licencimit sa ne shumicën e komunave takimet është dashur të zgjasin më shumë nga ajo që ka qenë e paraparë.

Këto takime dolën të jenë shumë të suksesshme, duke parë interesimin e mësimdhënësve në këto informacione që janë shumë të nevojshme për secilin mësimdhënës.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit në Kosovë

KEC

